



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.291/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Sh. G. nga fsh. ..., Komuna e R., të cilin e përfaqëson Av. Orhan Rekathati nga P., kundër të paditurve D. H. B. nga fsh. ..., dhe M. M. G., nga fsh. ..., Komuna e Gj., për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1290/2015 dt.28.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.09.2022, mori këtë,

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si i palejuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1290/2015 datë 28.01.2020.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1290/2015 të dt.28.01.2020 janë refuzuar si të pa bazuara ankesa e paditësit dhe e të paditurve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.62/2012 i dt.23.12.2014, me të cilin, pjesërisht miratohet kërkesëpadia e paditësit dhe vërtetohet se i njëjti është pronar i pjesës së parcelës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.12,13ha, në vendin e quajtur "Bare", me kulturë arë e kl.4, e cila evidentohet sipas nr..., ZK- X., në bazë të kontratës mbi shitblerjen e

cila është evidentuar pranë Gjykatës Komunale në Rahovec, Le.nr..., e cila nuk është zbatuar, prej datës 19.11.2007 dhe atë me këto dimensione: në anën verilindore kufizohet me parcelën kadastrale nr..., në gjatësi prej 22,47 m, në anën juglindoren me parcelën kadastrale nr..., në gjatësi prej 46,23 m, në anën jugperëndimore me parcelën nr..., në gjatësi prej 27,46 m dhe në anën veriperëndimore me parcelën kadastrale nr..., në gjatësi prej 61,46 m dhe detyrohen të paditurit, që t'ia pranojnë pronësinë dhe t'ia dorëzojnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë, si me bazë, ndërsa, kërkesëpapia e paditësit sa i përket pjesës së parcelës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 0.02,87 ha, në po të njëjtin vend e cila evidentohet sipas certifikatës pronësore nr.231, ZK- Z..., me këto dimensione : në anën verilindore, kufizohet me parcelën kadastrale nr..., rrugë regjionale Gjakovë – Prizren, në gjatësi prej 6.59 m, në anën juglindore me parcelën kadastrale nr..., në gjatësi prej 41,57 m, në anën jugperëndimore, me parcelën nr..., në gjatësi prej 8,38 m, dhe në anën veriperëndimore, me parcelën kadastrale nr..., në gjatësi prej 46.23 m, refuzohet si e pa bazë dhe ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të ndryshohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë, në kuptim që të aprovohet revizioni i paditësit, ose të njëjtit të prishen dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Kështu sepse, me dispozitën e nenit 211.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet se ” Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpapia nuk ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3000-euro”. Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se në rastin konkret ,e duke qenë se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit është 100- euro, përkatësisht, nuk e kalon vlerën prej 3000-euro, revizioni nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.291/2022 datë 23.09. 2022.

Kryetari kolegjit
Mr.Sc.Muhamet Rexha

